

Sky Tour

Dita e pare

65 euro

Nisja ne oren **6.00** te mengjesit nga Tirana ne drejtim te Komanit per te marre anijen qe do te na coje ne Fierze .Nisja me anije ne **oren 09 00**.

Pasi udhetojme per rreth **2 ore 30 minuta** me anije do te zbresim.Ketu na prët fugoni qe do te na coje **ne Valbone**. Ndalesa e pare do te jete ne **Bujan** ne shtepine e **Mic Sokolit** nje nder herojte tane Shqiptar te Zones se Tropojes dhe nje person qe pati nje influence te rendesishme ne takimin qe u be ne shtepine e Lidhjes se Prizrenit .



Valbone 15-16 Qershe

Me pas do ti drejtohem **Qytetit te Bajram Currit** ku dhe do te njihemi me nje nga qytetet me te vogla ne Shqiperi .Ketu do te bejme nje pushim te vogel **per kafe** .Me pas do te marrim rrugen per ne Valbone Udhetimi zgjat mesatarisht **1ore e 30 minuta** .Gjate rruges kemi mundesine te shikojme bukurite qe natyra qe i ka dhuruar kesaj zone.Rreth ores **14 00 te drekes jemi ne Valbone**.Pas mberritjes do te akomodohe mi ne dhoma dhe me pas **do te hame dreken** e prenotuar nga ne.

Sky Tour

Pas dreke do te bejme nje pushim te vogel dhe me pas do te vazhdojme guiden tone per rreth tek "**Fusha e Gjese**"(keshtu quhet nga vendasit) ku eshte dhe fundi i rruges qe mund te pershkoje minibusi.



Nga aty do te vazhdojme ecjen deri ne fillimin e lagjes se fundit te Valbones qe quhet Gjelaj. Aty do te kemi mundesine te shikojme pjesen me terheqese, fundin e lugines ku te gjitha majat e maleve jane mbi 2300, 2400m.



Si dhe kemi mundesi te shikojme dhe gryken e Valbones nga ku rrjedh dhe ky uje eshte nje terren alpin dhe i veshtire koha ne dispozicion **2 ore e gjysem ne kembe** .(opsionale)Kthehemi ne hotel .**Darka** e organizuar me muzike deri ne oret e vona.

Sky Tour



Dita e dyte

Pas mengjesit do te behemi gati per rrugen e kthimit po me anije nga Fierza (ndaj na duhet te nisemi heret nga Valbona rreth ores **04 30 – 05 00**) Anija niset ne oren **06 00** te mengjesit . Ndalesen e radhes ne rrugen e kthimit do ta bejme te **Vau I Dejes** ku mund te shfrytezojme rastin edhe per te drekuar tek **restorant Dea. (opsionale)**. Pas drekes nisemi serish per rruge. Ndalesa tjeter opsionale sipas deshires se grupit per kafe (**ndoshta ne Fishte ne Lezhe**). Mberritja ne Tirane rreth ores 21 00.

Fund I programit tone !

KESHILLA

Ju keshillojme qe per nje guide te tille duhet te merrni veshje sportive dhe atlete me vete duke pasur parasysh qe klima eshte e ftohte .

Menuja e Ushqimit



Mengjesi :Veze te skuqura ose te ziera sipas dëshires.

Djath, gjalp, buke fshati te bere vete .

Çaj mali, qumesht i fresket, .

Dreka : mish I pjekur qingji me garniture ose trofte me garniture sipas deshires.

P.s: Kjo menu i perket një personi të vetem, (mund të kemi edhe ndryshime sipas dëshirës së vizitorve).Pijet alkolike dhe kafja ekspresit nuk perfshihen ne kete kosto ato mund te merren me vete ose te porositen aty kundrejt nje pagese.

Ne cmimin 65 euro /personi perfshihet:

- Transporti Tirane – Koman dhe anasjelltas
- Bileta e anijes vajtje –ardhje
- Transporti Fierze –Valbone dhe anasjelltas
- Akomodimi nje nate te hoteli Burimet e Valbones
- Dreka e dites se pare
- Mengjesi I dites se dyte
- Shoqerues grupi gjate gjithe udhetimit

P.S Ky cmim eshte llogaritur per nje grup minimum 15 veta.